

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "TFP Hol" Sh.p.k.**

Sot, më datë 24 / 01 /2025,

**-Z. Ervin Çadri**, shtetas shqiptar, lindur me 24/01/1980, ne Tiranë, mbajtes i dokumentit te identifikimit me nr. personal I00124143F, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, " Për regjistrimin e biznesit ", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar " **TFP Hol**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "**TFP Hol**" Sh.p.k.

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Sami Frasheri", Pallati Vega, Shkalla 1, Ap. 33, Tirane,1001.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**


Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Blerjen, shitjen, shkëmbimin, dhënien me qira dhe nënqira të pasurive të paluajtshme të veta dhe/ose të palëve të treta dhe administrimin e pasurive të paluajtshme në pronësi të shoqërisë.
- Ndertimin e objekteve dhe punimeve civile dhe industriale, projektim, studim, zbatim,
- Aktivitete arkitekturore dhe konsulencat perkatese,
- Kryerja e cdo lloj veprimtarie tjetër te nevojshme ose te dobishme ne kuader te realizimit te qellimeve te Shoqerise.
- Investime,
- Pjesemarrje ne kuota,
- Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne fushen e: Ndertimit, studimit, projektimit,



- Studim, projektim, ndërtim, prodhim, shpërndarje dhe instalimin dhe montimin përkatës të orëndive, mobiljeve në përgjithësi, aksesorëve dhe aksesorëve të arredimit;
- Projektimin, ndërtimin, instalimin dhe montimin e pajisjeve të brendshme dhe të jashtme;
- Ushtrimi i aktiviteteve që rrjedhin apo që ndihmojnë në realizimin e objektivave të mesipër kryesore.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 2.000.000 Lekë (*dy milion*) Lekë dhe është i përbërë nga një kuote.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Ervin Çadri**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 2.000.000 Lekë (*dy milion*) Lekë dhe 2.000.000 Lekë (*dy milion*) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicën të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

**Z. Ervin Çadri**, shtetas shqiptar, lindur me 24/01/1980, në Tiranë, mbajtes i dokumentit të identifikimit me nr. personal I00124143F, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



**NENI 8**

**DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku i vetem themelues i shoqërisë, duke autorizuar *Administratorin Z. Ervin Çadri* për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

**ORTAKU THEMELUES**

**ERVIN ÇADRI**

